



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 12/2011
Prishtinë, më 25.05.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Biserka Kostić dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Gani Berisha, Ibush Luzha dhe Selvie Çeku- MTI; Ardian Kryeziu dhe Arben Abdullahu – USAID/BEEP; Emrush Ujkani dhe Igor Guton-EU/ SME(Komisioni Evropian); Ukë Gashi - ZPRK; Fitim Salihu – KDI dhe Lejla Selimi - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare e Komisionit në piken e 1 dhe 2 të rendit të ditës, ndërsa pikat tjera i kryesoi kryetari Zenun Pajaziti.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja- konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja - propozoj që të shtohet edhe një pike rendit të ditës si pika trete (3) Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente e Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim, për shkak se Grupi punues ka hartuar Raportin me propozim-amendamente.

Propozimi u përkrash nga Komisioni dhe rendi i ditës u miratua si në vijim:

1. *Miratimi i rendit të ditës;*
2. *Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare;*
3. *Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente e Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim;*
4. *Të ndryshme.*

2. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare;

Kryesuesja – ne cilësinë e raportueses se Grupit punues për Projektligjin nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, paraqiti Raportin me Propozim-amendamente te Projektligjit. Shtoj se për këtë Projektligji Grupi punues ka realizuar tri takime dhe është konsultuar më përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; USAID-it; Komisionit Evropian dhe më Njësinë mbështetse të Komisionit, kemi përgatitur 12 propozim-amendamente, si ne vijim: **Amendamenti 1** Neni 1 fshihet; **Amendamenti 2** Neni 2 ndahet në dy nene; **Amendamenti 3** Paragrafi 4 i Nenit 3 ndahet në dy pjesë; **Amendamenti 4** ndryshon Nenin 6; **Amendamenti 5** ndryshon Nenin 10; **Amendamenti 6** ndryshon Nenin 11; **Amendamenti 7** ndryshon Nenin 12; **Amendamenti 8** risistemon Nenet 13,14,15,16,17 dhe 19; **Amendamenti 9** ndryshon Nenin 15; **Amendamenti 10** risistemon Nenet 16,17,18 19 dhe 20; **Amendamenti 11** ndryshon Nenin 19; dhe **Amendamenti 12** ndryshon Nenin 21.

Vërejtjet ne Amendamente

Amendamenti 4

Ardian Kryeziu (USAID/BEEP) - tha qe ne kemi sjellur disa rekomandime, lidhur me amendamentin 4 te nenin 6 propozimi që parasheh nxjerrjen e Udhëzimeve administrative për përcaktimin e gjobave, është se nuk ka nevojë farë që të parashihen gjobat për mosregjistrim të bizneseve, e me pak me akte nënligjore. Edhe pse ne këtë rast gjobat duhet të parashihen me ligj, USAID-i rekomandon që gjobat të mos përfshihen përmes ligjit sepse janë të panevojshme ngase nuk i shërbejnë asnjë qëllime publik. Mirëpo kjo çështje është e rregulluar ne Nenin 249 te Kodit Penal të Kosovës ku parasheh veprën e posaçme penale “ shmangia nga tatimi”. Theksoj që për këtë janë ligjet tatimore që me ndonjë rregullore mund ta rregullojnë këtë fushë.

Myzejene Selmani - tha që gjatë shqyrtimit ne grup punës e patëm potencuar që të hiqen gjobat

Gani Berisha (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) - tha edhe gjatë punës kur e kemi bërë këtë projektligj, çështjen e gjobave e kemi lënë të hapur për mos regjistrim te bizneseve, sepse ne

nuk kemi dashur që me një here ti sanksionojmë, për mosregjistrim, por te ju leme një afat kohor që ta bëjnë regjistrimin biznesit.

Myzejene Selmani - tha që me këtë po ju lihet hapësirë ekonomisë joformale, andaj ne si Komision funksional duhet ta rregullojmë mire çështjen bizneseve.

Hashim Deshishku - tha që gjrobat duhet të mbesin në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin e Biznesit nëse duhet të gjobitën.

Berat Buzhala - pyeti përfaqësuesit nga USAID dhe MTI-ja, a mund të na sqaroni pse mos me mbet gjrobat?

Ardian Kryeziu (USAID/BEEP) - theksoi që nuk përjashtohen prej gjobave, por duhet të inkurajohen për biznes të mëtutjeshme.

Gani Berisha (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) - tha që në neni 6 është shumë i qartë, por është fjala për shoqërinë aksionare, e cila nuk është e regjistruar.

Emrash Ujkani (EU/SME - Komisioni Evropian) - tha që e përkrahë idenë e propozuar nga USAID që çështja e gjobave të rregullohet me Kodin Penal të Kosovës

Sala Berisha – Shala - tha se në qoftë që biznesi nuk është i regjistruar nuk mund të dënohet me Kodin Penal të Kosovës.

Kryetari - tha më qene se e mbulon Kodi Penal këtë çështje atëherë ka bazë ligjore le të mbetet që kjo çështja të rregullohet me Kodin Penal.

Pas debatit, Komisioni me 8 vota Për dhe me abstenim të deputetit Lutfi Zharku, miratoi këtë amendament:

Amendamenti 4

Neni 6 ndryshohet si vijon:

*1. Në nenin 3 të Ligjit në fuqi paragrafi 3.3. fshihet dhe riformulohet me tekstin si vijon:
3.3 Përveç siç parashihet në paragrafin 2 të këtij neni ose paragrafin 2 të nenit 37 të këtij ligji, nëse një person i cili nuk është e regjistruar ushtron veprimtari tregtare në Kosovë, atëherë personi në fjalë ka bërë shkelje të këtij ligji, dënohet sipas Kodit Penal.*

Amendamenti 5

Lutfi Zharku – theksoj se nuk ka nevojë që paragrafi 3 ti shtohet teksti: me zotësi veprimi. Sepse me këtë po e detyron biznesin që të sjell ende dokumentacion shtese.

Propozimi i përkrah nga Komisioni dhe Amendamenti 5 nuk kaloi.

Amendamenti 6

Lutfi Zharku- propozoj që Amendamenti 6 në neni 11 të jetë ditë kalendarike.

Pas debatit Amendamenti 6 kalon me 8 vota Për dhe 1 kundër të deputetit Lutfi Zharku.

Amendamenti 8

Ardian Kryeziu (USAID/BEEP) – theksoi se paragrafi 5 i Nenit 13 është i panevojshëm sepse vetëm sa ngarkohet biznesi me regjistrim te shoqërive tregtare pas njoftimit për vendimet e tyre.

Lutfi Zharku – theksoj se është legjitime të regjistrohet shoqëria tregtare për ndryshimet në statut dhe marveshje sepse vetëm me njoftim është e paarsyeshme.

Pas debatit, Komisioni me 8 vota Për dhe me 1 kundër te deputetit Lutfi Zharku, miratoi amendamentin duke e fshirë paragrafin 5 të nenit 13 të Projektligjit.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente e Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim

Kryetari – ia kaloj fjalën raportuesës znj.Sahatqija për të paraqitur Raportin me propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim.

Teuta Sahatqija - tha së Projektligji për Akreditim Grupi punese ka shqyrtuar më datë 24.05.2011, dhe është konsultuar më përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Komisionit Evropian dhe më Njësinë mbështetse të Komisionit, ka përgatitur 6 propozim-amendamente dhe i paraqiti para anëtareve të Komisionit, si në vijim: **Amendamenti 1** ndryshon Nenin 1; **Amendamenti 2** ndryshon Nenin 4; **Amendamenti 3** ndryshon Nenin 3; **Amendamenti 4** ndryshon disa paragraf te Nenit 4; **Amendamenti 5** zëvendëson akronimet e Nenit 5; dhe **Amendamenti 6** ndryshon Nenin 6.

Vërejtjet në Amendamente

Amendamenti 2

Ibush Luzha (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) - Tha e kemi propozuar ne nenin 2 që Drejtoria e Akreditimit të Kosovës i ka burimet e duhura financiare dhe personel për kryerjen e detyrave. Për arsyeje që na është rekomanduar nga Komisioni Evropian që ta kemi edhe pse ne si Drejtori e akreditimit të Kosovës, ende nuk jemi anëtar si shtet në Bashkimin Evropian, por na është thënë që ta kemi vetëm para Komunitetit Ekonomik Evropian. Dhe nuk kemi nevojë për buxhet shtesë, për të funksionuar kjo drejtori.

Emrush Ujkani (EU/ SME-Komisioni Evropian) - theksoj që Komisioni Evropian e përkrah MTI-n edhe në këtë rast e mbështet Drejtorin e Akreditimit të Kosovës sepse nuk ka ndonjë implikim buxhetor.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë amendament:

Neni 2 ndryshohet si vijon:

1. Në nenin 4 të Ligjit pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:

5. Ministria përkatëse duhet të sigurojë që organi kombëtar akreditues i tyre i ka burimet e duhura financiare dhe personel për kryerjen e detyrave të tyre, duke përfshirë përmbushjen e detyrave të veçanta, të tilla si aktivitetet për bashkëpunim evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit dhe aktivitete të cilat janë të nevojshme për të mbështetur politikat publike dhe të cilat nuk janë të vetë-financuara.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim, dhe u dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

4. Të ndryshme.

a) Mbledhja e radhës

Kryetari – propozoj që në mbledhjen e radhës si pike rendit të ditës të jetë: Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor;

b) Aktivitet e radhës të Komisionit;

Kryetari – Kërkoj nga stafi i komisionit mbështesë që në bazë të planit të punës ta caktojë takimin e radhës për vizitë punë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit